



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Berat, më \_\_\_\_\_ 2024

**MIRATOI**

**KRYETARI I BASHKISË**

**ERVIN DEMO**

**RELACION**

**MBI ZBATIMIN E URDRIT TË KRYETARIT TË BASHKISË NR.84, DATË  
31.01.2024**

**“PËR LLOGARITJEN E KOSTOS PËR GRUMBULLIMIN DHE TRANSPORTIMIN E  
MBETJEVE PËR NËNTË MUAJ, PËR BASHKINË BERAT”.**

Në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.84, datë 31.01.2024, “Për llogaritjen e kostos për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve për nëntë muaj, për Bashkinë Berat”, u mbledh komisioni i përbërë nga;

- Arisa Toska           Sekretar i Përgjithshëm ,
- Erlin Kuçi   Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve
- Klea Hajrullaj,       Specialist i Politikave për Menaxhimin e Mbetjeve
- Erinda Toto           Specialist Jurist
- Kamberi Selimaj   Përgjegjës i Sektorit të Financës, në Agjencinë e Shërbimeve Publike
- Etleva Dhima       Drejtor i Drejtorisë së Integritimit European dhe Projekteve
- Anxhelo Dhimo      Specialist Kadastre



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

Pavarësisht cilësisë dhe problemeve që lidhen me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri, kuadri ligjor ka përparuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit. Komisioni për llogaritjen e kostos për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve për nëntë muaj, për Bashkinë Berat është mbështetur në legjislacionin në fuqi në VKM nr.319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” por edhe në referim Vendimit nr.49, datë 30/11/2023 “ Për miratimin e studimit dhe fondit për shërbimin shtesë të pastrimit dhe transferimin e tyre në SHA “ Berat City Green” Shoqëri Aksionare me 100% të Aksioneve të Bashkisë Berat”, " Studimi është pjesë e projektit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Bashkisë Berat dhe Ambasadës Suedeze, zbatuar nga Instituti i Kerkimeve Urbane dhe Brooke Hannas and Partners.

Llogaritja e kostos në zbatim të urdhrit e nr.84, datë 31.01.2024, “Për llogaritjen e kostos për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve për nëntë muaj, për Bashkinë Berat”, bazohet mbi aktet ligjore e nënligjore si më poshtë :

- Ligjin nr.10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar
- VKM nr.319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve “
- VKM nr.113, datë 1.3.2023 “ Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”

### Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

Zbrazen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në vendin e depozitimit të tyre.

### Frekuencat e grumbullimit

**a.Në zonën 1** Qyteti, shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet çdo ditë të javës. Oraret e grumbullimit do të jenë natën, nga ora 20.00 deri në orën 06.00, kështu do të evitohen orët me trafik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

**b.**Në **zonën 2** Njësia administrative Otlak, shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet 4 ditë të javës, **të martë, të mërkurë, të premte dhe të shtunë**. Oraret e grumbullimit do të jenë natën, nga ora 20.00 deri në orën 06.00, kështu do të evitohen orët me trafik.

**c.** Në **zonën 3** Njësia administrative Sinjë dhe Velabisht, shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet 2 ditë të javës, **të hënë dhe të enjte**. Oraret e grumbullimit do të jenë natën, nga ora 20.00 deri deri në orën 06.00.

**d.**Në **zonën 4** Njësia administrative Roshnik dhe fshati Duhanas, shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet 2 ditë të javës, **të martë dhe të premte**. Oraret e grumbullimit do të jenë natën, nga ora 20.00 deri në orën 06.00, kështu do të evitohen orët me trafik.

### Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve

**a.**Autoriteti kontraktor ka përcaktuar pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrin e kontenierëve për secilën pikë në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit.

**b.**Kontraktuesi është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të kontraktuesit ose nga Autoriteti kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.

**c.**Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

### Rregulla për tu zbatuar

**a.** Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e kontraktuesit dhe do të vendosen penalitete.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

**b.**Kontraktuesi ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambiente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

**c.**Kontraktuesi duhet të ketë në efikasë një “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00. Përfaqësues të kontraktuesit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor dhe për t’u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 2 orësh nga marrja e njoftimit.

**d.**Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

**e.**Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

**f.**Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbetjeve urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt, operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

**g.**N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballlet me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoha të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

### **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha shërbimeve plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:



Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

| Nr | Emertimi i mjetit                        | Kapaciteti mbajtës | Sasia (copë) |
|----|--|--------------------|--------------|
| 1  | Makinë teknologjike kompaktor (ngjeshës) | Jo me pak se 5 ton | 2            |
| 2. | Makinë teknologjike kompaktor (ngjeshës) | Jo me pak se 10ton | 2            |

|   |  |
|---|--|
| <b>Lloji i mjetit</b>                           | <b>Mjet teknologjik transportues (kompaktor)</b>   |
| Ngarkimi fundor i makinës (kapaciteti i mjetit) | 10ton/5ton<br>   |
| Raporti i Kompaktimit                           | 1:4 – 1:6  |
| Kapja e mjetit në pjesën fundore                | Duhet të jetë me krahë kapës për kontenierë me volum 1100 litra (1.1m <sup>3</sup> )<br> |
| Rrotat e mjetit                                 | Duhet të jenë rrota të mëdha të cilat të mund të lëvizin lirisht në territore malore dhe të mbuluara me borë   |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

|                    |        |
|--------------------|--------|
| Lënda djegëse      | Diesel |
| Marshi             | Manual |
| Klasa e shkarkimit | Euro 5 |

**a.**Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se **2(dy) copë**;

**b.**Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak **2(dy) copë**; [1 në punë dhe 1 rezervë]

Duke u nisur nga metodologjia e shërbimit të pastrimit për territorin e Bashkisë Berat janë përlogaritur që për kryerjen e këtij shërbimi janë të nevojshme makinerite të mesiperme me tonazh 5 ton/10ton. Përlogaritja e kostos së këtij shërbimi dhe kohën e caktuar janë kryer duke marrë në konsideratë makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se 2(dy) copë dhe makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak 2(dy) copë; [1 në punë dhe 1 rezervë]. Tonazhi prej 10 ton është përlogaritur për zonën urbane ku gjenerimi i mbetjeve është më i lartë dhe numri i kontenierëve është më i lartë në krahasim me zonat e tjera. Tonazhet prej 5ton janë përlogaritur prej numri të kontenierëve më pak në zonat rurale, dhe në zonat urbane ku makinat me tonazh 10 tonësh nuk mund të futen. Tabelat bashkëlidhur për argumentimin e tyre bazuar në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

### **Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

**a.**Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, duhet të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjendjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

**b.**Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuar nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.

**c.**Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

**d.**Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefonit i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet dhe kontenierët e shpërndarë përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet te prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mbliidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat.

**e.**Bashkia në plan ka parashikuar një mundësi të lëvizjes së mjeteve, por kompania duhet të mundësojë një hartë të rrugës që ndjek mjeti për grumbullimin e mbetjeve në zonën përkatëse dhe kalendarin përkatës.

**f.**Kontraktuesi do të realizojë instalimin e sistemit të GPS në të gjitha mjetet teknologjike e jo teknologjike. Kontraktuesi duhet të mundësojë realizimin e sistemit të monitorimit edhe nga Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet Serverit qendror të sistemit GPS. Kjo do të mundësojë një raportim ditor dhe javor të lëvizjes të të gjitha mjeteve që Autoriteti Kontraktor duhet t'ua bashkangjisë raporteve të monitorimit në terren. Do të monitorojë të gjitha lëvizjet e mjeteve teknologjike në zonat përkatëse dhe do të ketë mundësi kontrolli më të mirë në lidhje me rrugën e mjeteve, ndalesave të tyre në pikat e grumbullimit të mbetjeve, minutazhin që mjetet harxhojnë për zbrazjen e kontenierëve dhe kohën që ato harxhojnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Sistemi i GPS nuk duhet të fiket asnjëherë dhe për asnjë lloj arsye. Nqs rezulton sistemi i fikur, kontraktuesi do penalizohet.

### **Kushtet teknike për mjetet e transportit**

**a.**Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjendje të mirë teknike për të mundësuar grumbullimin e mbetjeve.

**b.**Makinat teknologjike duhet të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenierët që do të përdoren në NjA.

**c.**Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e nje cikli të plotë (ngritjen e kontenierit, shkarkimin dhe uljen e tij me 120 kg) në një periudhë kohe të caktuar.

**d.**Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vete dhe nuk duhet që puntorët të ngrenë kontenierin për ta varur atë në këtë sistem.

**e.**Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjendje të mirë, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike.

**f.**Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

**g.**Dritat e përparme dhe të pasme duhet të jenë në gjendje të mirë dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisura me reflektorë.

**h.**Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisura me pasqyra të jashtme për të pasur një vizion të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.

**i.**Të gjitha investimet, mirëmbajtja dhe në qoftë se është e nevojshme edhe kostot e zëvendësimit të pjesëve janë të gjitha për t'u paguar nga kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e makinave teknologjike dhe për faktin që ata duhet të jenë të gjithë në gjendje pune.

**j.**Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situata nuk duhet të kenë ndonjë influencë apo ndikim mbi sasinë dhe cilesinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

**k.**Makinat teknologjike duhet të lahen çdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjienik të mbetjeve.

**l.**Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregojë të gjithë informacionin për punën e bërë cdo ditë: orën kur ka filluar grumbullimi, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe numrin e kontenierëve të mbledhur.

**m.**Kompania duhet të ketë gjithashtu një regjistër për çdo makinë teknologjike, ku të jepet i gjithë informacioni në lidhje me karburantin (datat, orët dhe sasinë), vajin dhe të tjera aktivitete të mirëmbajtjes.

**n.**Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë njësitë administrative duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

### Personeli

**a.**Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe transporton mbetjet.

**b.**Stafi i mësipërm do të punësohet me shpenzimet e kompanisë. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i pajisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe pajisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

Kërkesa për punëtor

| Nr | Specialiteti                           | Njësi   | Sasi |
|----|--|---------|------|
| 1  | Shoferë                                | Persona | 5    |
| 2  | Punëtor makine për grumbullim mbetjesh | Persona | 9    |
|    | Shuma                                  |         | 14   |

Duke u nisur nga numri i makinerive të kërkuara makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se 2(dy) copë dhe makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak 2(dy) copë; [1 në punë dhe 1 rezervë] në total prej 4 copë është përlogaritur numri i shoferëve që duhet për kryerjen e këtij shërbimi, konkretisht 4 mjete duan 5 shofera per 360 dite pasi nje shofer eshte perlllogatur sipas kodit te punes te punoj jo me shume se 172 ore pune. Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe transporton mbetjet. Sipas metodologjisë së përdorur bazuar në legjislacionin në fuqi janë përlogaritur që për 3 makineri duhen 6 punëtorë dhe 3 punëtor janë llogaritur plotësues.

### **Menaxhim dhe mirëmbajtje kontenieresh.**

Pronësia e kontenierëve do të jetë e bashkisë, ndërsa kompanita do të jetë përgjegjëse për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

### **Menaxhimi i kontenierëve:**

**a.** Vendorsja e kontenierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosë kontenierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkesë fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Të gjitha lëvizjet e kontenierëve janë të përfshirë në çmimin e kontratës. Kontraktuesi duhet të ketë një mjet që do të mundësojë zhvendosjen e kontenierëve.

**b.** Kontenierët do të identifikohen me një numër rendor dhe një barkod, që do të mundësojë identifikimin digital të tyre nga grupi i monitorimit në bashki. Kontraktuesi duhet të mbajnë një databazë me të gjithë kontenierët.

### **Grafikët e punimeve**

**1.** Grafikët e punimeve për transportin, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontraktor.

**2.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penaltete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

### **Vendi i depozitimit të mbetjeve**

Mbetjet urbane do të depozitohen për trajtimin përfundimtar në sheshdepozitimin në fshatin Orizaj, Njësia Administrative Otlak.

Operatori i shërbimit do të shkarkojë mbetjet urbane në venddepozitimin pranë fshatit Orizaj.